



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 3174 Prot

Vlorë 09.10.2018

VENDIM

Nr. 40, datë 28.09.2018

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES OPERACIONALE
NDËRMJET MINISTRISË SË EUROPËS DHE PUNËT E JASHTME
DHE KËSHILLIT TË QARKUT VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28.09.2018, në mbështetje të Nenit 14 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” mbi “Bashkëpunimin me dy a më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore”, pasi mori në shqyrtim Marrëveshjen Operacionale të Ministrisë së Europës dhe Punët e Jashtme,

VENDOSI:

1. Të miratojë Marrëveshjen Operacionale ndërmjet Ministrisë së Europës dhe Punët e Jashtme dhe Këshillit të Qarkut Vlorë me objekt: “Detyrat dhe përgjegjësitë në zbatimin e projekteve të financuara nga programi INTERREG IPA i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020”.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas pikës 3 të Nenit 78 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën me Nr ___ Prot. Dt ___/___/___

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Sheshi “ 4 Heronjtë ”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov
Tel: +355 33 421 600